

2. Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “klientë”, “palë në proces gjyqësor”, “persona të tretë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.
3. Në kuadër të verifikimit të ankesës së administruar me nr. 631 prot., datë 18.03.2022, të paraqitur nga _____ konstatohet se, Kontrolluesi, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në cilësinë e avokatit përfaqësues me prokurë të paditëses _____, në procesin gjyqësor me nr. _____ Regj. Themeltar, të regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përgjatë seancës gjyqësore të datës 18.06.2021, ka paraqitur në cilësinë e provës, listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të punonjësve të _____, për muajt Prill 2020 dhe Dhjetor 2020. I pyetur nga Zyra e Komisionerit përmes shkresës nr. 631/1 prot., datë 06.04.2022, mbi mënyrën e sigurimit të informacionit, si dhe mjetet që ka përdorur për përpunimin e të dhënave personale, në rastin konkret, Kontrolluesi pretendon se i ka siguruar në rrugë elektronike nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.
4. Nga verifikimet e kryera nga Zyra e Komisionerit, përmes korrespondencave shkresore, me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH Tiranë) dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (DRT Tiranë), për të provuar mënyrën e sigurimit të listëpagesave nga ana e Kontrolluesit, rezulton se DRSSH Tiranë, përmes shkresës nr. 7108/1 prot., datë 11.05.2022, si dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj përmes shkresës nr. 5548/1 prot., datë 16.06.2022, mbajnë qëndrimin se, këto listëpagesa nuk janë siguruar prej tyre, pasi nuk kanë asnjë korrespondencë shkresore apo elektronike me z. Gazidede, ndryshe nga sa ka pretenduar Kontrolluesi.
5. Kontrolluesi, pasi dhe u vu në dijeni për shkresat e sipërcituara dhe qëndrimin e mbajtur nga dy autoritetet publike, gjatë inspektimit u pyet përsëri nga grupi i inspektimit mbi mënyrën e sigurimit të listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të punonjësve të _____, për muajt Prill 2020 dhe Dhjetor 2020. Kontrolluesi konfirmon qëndrimin e tij se, pasi ka paraqitur një kërkesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore, i ka marrë ato përmes postës elektronike nga një punonjës i këtij institucioni, por nuk zotëron asnjë dokumentacion provues lidhur me sa pretendon. Gjithashtu, listëpagesat e siguruar prej tij i ka vendosur në dispozicion të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në funksion të procesit gjyqësor dhe janë pjesë e dosjes gjyqësore.
6. Kontrolluesi, nuk arriti të provoj se mbledhja/ përpunimi i të dhënave personale në rastin konkret, është kryer në mënyrë të ligjshme, duke respektuar parimet e

mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në nenin 5 dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, (në vijim, “Ligji”).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit. Në përmbajtje të procesverbalit Kontrolluesi parashtroi se:

“Nuk kam shkelur etikën si avokat, bazuar në nenet 6-9 të Ligjit për Avokatin në Republikën e Shqipërisë, pasi këto të dhëna nuk janë përdorur përveçse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Do paraqes me shkrim pretendimet e mia në seancën dëgjimore”.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, pala është ftuar të marr pjesë në seancë dëgjimore, në datën 22.07.2022, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku parashtroi qëndrimin e tij me shkrim mbi konstatimet e grupit të hetimit.

Kontrolluesi në mënyrë të përmbledhur parashtroi argumentet si më poshtë:

- *Përpunimi i këtyre të dhënave është bërë vetëm për mbrojtjen e të drejtave legjitime e kushtetuese të personit të mbrojtur, konkretisht paditëses , përkundër shoqërisë , pasi kjo shoqëri i ka zgjidhur marrëdhënien e punës në kohë të papërshtatshme, (pas lejes së lindjes), pa shkaqe të justifikuara, duke abuzuar me të drejtën e mos informimit publik për numrin e të punësuarve në periudha të ndryshme, dhe duke falsifikuar qëllimisht shkakun e largimit nga puna, për shkak të ristrukturimit.*

Lidhur me argumentin e sipërcituar, të parashtruar nga Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në përcaktimet e nenit 11 të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Avokati, në ushtrim të profesionit të tij, ka të drejtë të kërkojë të dhëna, shpjegime ose dokumente që kanë lidhje me çështjen ose klientët që përfaqësohen ose mbrohen prej tij, nga çdo institucion i administratës publike, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Megjithatë, sikurse citohet edhe në dispozitën e sipërcituar, të legjislacionit specifik, Avokatit i garantohet e drejta që të mbledh informacione nga autoritetet publike në funksion të procesit gjyqësor, që ka lidhje me çështjen ose klientët që përfaqësohen ose mbrohen prej tij, por përpunimi i të dhënave personale/mbledhja në rastin konkret, duhet të kryhet nga kontrolluesi në mënyrë të ligjshme.

Në rastin konkret, Kontrolluesi nuk arriti që të provojë përpara Zyrës së Komisionerit, përmes provave se, i është drejtuar me një kërkesë zyrtare, në rrugë shkresore apo

elektronike autoriteteve publike, dhe listëpagesat që ka vendosur në dispozicion të gjykatës i ka siguruar në një mënyrë të ligjshme, duke respektuar parimet e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në nenin 5 të Ligjit.

Mbledhja e të dhënave personale të punonjësve të shoqërisë gjithashtu tejkalon të drejtën e Avokatit për të kërkuar të dhëna, shpjegime ose dokumente që kanë lidhje me çështjen ose klientët që përfaqësohen ose mbrohen prej tij, pasi listëpagesat e marra nga ana e tij, në përmbajtje kanë të dhëna personale edhe të punonjësve të tjerë të shoqërisë, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale të tyre, në rastin konkret. Kontrolluesi që të legjitimohet për përpunimin e të dhënave personale duhet të plotësoj kriteret ligjore për përpunimin të sanksionuara në nenin 6 të Ligjit.

- *Përpunimi i këtyre të dhënave nuk ka rrezikuar në asnjë mënyrë të drejtën e subjekteve të të dhënave, pasi këto të dhëna i janë depozituar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe këto të dhëna nuk janë bërë publike pasi është detyrë e Avokatit që të ndalojë publikimin e këtyre të dhënave që i ka marrë nga pala e paditur ose nga organi publik dhe të cilat janë përdorur në hetimin gjyqësor.*

Lidhur me argumentin e sipërcituar, të parashtruar nga Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, pavarësisht se nuk u provua, që Kontrolluesi ti ketë bërë publike këto listëpagesa apo ti ketë përdorur përveçse në funksion të procesin gjyqësor, ku ka mbajtur cilësinë e përfaqësuesit ligjor, legjislatori nuk e ka lidhur përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale detyrimisht me ardhjen e pasojave. Pra, edhe pse nuk u provua që këto listëpagesa janë përdorur/përhapur përveçse në funksion të procesit gjyqësor, Kontrolluesi nuk përjashtohet nga përgjegjësia për të përpunuar/mbledhur të dhënat personale në përputhje me Ligjin.

- Vetë subjekti i të dhënave, shoqëria ka paraqitur në procesin gjyqësor Deklaratat për kontributet e sigurimeve shoqërore të kësaj shoqërie në muajin prill dhe qershor për të vërtetuar shkurtimin e organikës, pra për të provuar qëllimin e largimit nga puna të paditëses, ku janë të njëjtat të dhëna personale të të gjithë punonjësve të shoqërisë.

Lidhur me argumentin e sipërcituar, Zyra e Komisionerit sqaron se, nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 10.11.2021, rezulton se, vendosja në dispozicion e kësaj prove pranë gjykatës, është realizuar në funksion të përmbushjes së detyrimit të caktuar nga gjykata përkundrejt shoqërisë, në cilësinë e palës së paditur, për paraqitjen e kësaj prove në formën e kërkuar nga ligji.

Lidhur me sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në pikën 12 të nenit 3 të ligjit, proceset si: mbledhja, konsultimi, shfrytëzimi, shpërndarja ose ndryshe vënia në dispozicion, janë procese përpunuese të të dhënave personale, për rrjedhojë mbledhja e të dhënave personale nga Kontrolluesi në rastin konkret duhet ti nënshtrohet detyrimeve të Ligjit.

Neni 5 i Ligjit sanksionon, parimet në të cilat bazohet mbrojtja e të dhënave personale, (*përpunimi në mënyrë, të drejtë dhe të ligjshme; në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, etj.*) të cilat janë të detyrueshme për çdo Kontrollues, në proceset përpunuese që kryejnë, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre sipas legjislacionit specifik.

Gjithashtu, neni 6 i Ligjit përcakton kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, plotësimi i të paktën njërit prej tyre përbën detyrim ligjor për çdo Kontrollues, përpara se të përpunoj të dhëna personale të subjekteve të të dhënave.

Lidhur me rastin konkret, në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në provat e grumbulluara në funksion të kësaj procedure administrative, nuk u provua se Kontrolluesi ka përpunuar/mbledhur të të dhënave personale duke përdorur një mënyrë të ligjshme, si dhe duke respektuar njëkohësisht parimet e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në nenin 5 dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit. Gjithashtu, pavarësisht se, Kontrolluesi nuk përjashtohet nga përgjegjësia për të përpunuar/mbledhur të dhënat personale në përputhje me Ligjin, nga hetimi administrativ i ushtruar, nuk rezultoi që Kontrolluesi të ketë përdorur/përhapur më tej të dhënat personale të mbledhura, përveçse në funksion të procesit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 31 pika 1, germa “a/1” të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5 të Ligjit, të ketë në vëmendje dhe të marrë masa që mbledhja e të dhënave personale nga ana e tij, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij si Avokat, të kryhet në mënyrë të ligjshme, informacioni të grumbullohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me këto qëllime, duke ju përmbajtur gjithashtu parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
2. Kontrolluesi, të marrë masa që përpunimi i të dhënave personale (*mbledhja/grumbullimi, etj*) të kryhet në përputhje me kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale të parashikuara në nenin 6 të Ligjit;
3. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose

përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 26.7.2022.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

